

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gazeta britanike: Shqipëria noton në para droge, Rama nuk kërkon falje për rolin e të atit në varjen e Ha vzi Nelës
ADRESA	https://piranjat.al/politike/gazeta-britanike-shqiperia-noton-ne-para--rama-nuk-kerkon-falje-pe-i103789
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 11:06:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 11:04:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b9856a84701bd13d90bfe0d219dd89db47da98b8975ac9208a7a070a06ff3e57
TEKSTI	54c66113755efbdf3662ac62f4977c93efa024d09190e1d6d5017ce756cdcaf0
PAMJA	be22386a564f1f426df2d145c0d07f19e36b2134288f05b894129f74d8e14d4a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aac93693d295c3f89c2b7ee72995ba84a6746048c257d7cf983e9304239473e7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	ec54c06a5f3c7f28099f77edc2da79ff2af36ac317165ec9e0f07ad8a247d7a6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aac93693d295c3f89c2b7ee72995ba84a6746048c257d7cf983e9304239473e7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

**për ta pritur
në Rinas**

Uj në Shtetet
e Bashkuara
të Amerik...

**ndërtimit
të**

Muzeu
Hebraik
në Vlorë,

**rezulton i
kërkuar në**

Greqi,
rezulton
person në

**punës,
humb**

ne ishuan
Trojas, ku
një 32-
vjeçar

**Bullgari,
dysohet**

shtatori zjarri në një
depo armësh
në Bullgarinë qendrore
në një natë

[POLITIKE](#)

Gazeta britanike: Shqipëria noton në para droge, Rama nuk kërkon falje për rolin e të atit në varjen e Havzi Nelës

Piranjat Përditësimi i fundit 12 Shtator 2026, 13:04



Gazeta e rëndësishme britanike 'Observer', publikoi një reportazh të gjatë për protestat që kanë kapluar Shqipërinë prej më shumë se tre muajsh. Vetë gazetari Andrew Anthony ishte i pranishëm gjatë njëres nga këto protesta dhe sjell përshkrimet e mëposhtme:

Në një mbrëmje të nxehtë e të lagësht muajin e kaluar, iu bashkova protestuesve në Bulevardin Dëshmorët e Kombit, pak në jug të Sheshit Skënderbej, sheshit të madh qendror të Tiranës, i cili është një trashëgimi e pushtimeve austro-hungareze dhe italiane. Gjatë viteve të komunizmit, kjo lagje ishte një sektor i ruajtur rreptësisht, i rezervuar për zyrtarët elitare të partisë. I njohur si Blloku, ai kishte akses në dyqane që kishin ushqime dhe llojin e mallrave të konsumit për të cilat pjesa tjetër e vendit vetëm mund të ëndërronte.

Tani ai është pushtuar nga qytetarët. Çdo mbrëmje, përmes një sistemi amplifikimi, mbahen një sërë fjalimesh. Sonte, folësja më e apasionuar është një grua e moshuar e veshur me të zeza. Emri i saj është Lavdije Nela, një ish-e burgosur gjatë diktaturës komuniste. Ajo është gjithashtu e veja e Havzi Nelës, një poet dhe kritik i atij regjimi, i cili u ekzekutua publikisht 38 vjet më parë, pikërisht në këtë ditë. Krimi i tij, në thelb, ishte se donte të ishte i lirë.

E veja e tij i thotë turmës se diktatori Ramiz Alia, i cili pasoi Hoxhën pas vdekjes së tij në vitin 1985, kishte firmosur refuzimin e kërkesës për falje të bashkëshortit të saj – në fakt, urdhrin e tij të vdekjes. Alia e konsideronte veten të hapur ndaj ndryshimit. Ai i lehtësoi rregullat në mënyrë që fermerët të mund të kishin dy dele – për sa kohë që ato ishin të së njëjtës gjini, sepse shumimi ishte rreptësisht i ndaluar. Por ai ende kishte prirjen për të ekzekutuar disidentët.

Një tjetër firmë në refuzimin e kërkesës për falje i përkiste një skulptori të quajtur Kristaq Rama, i cili ishte anëtar i Kuvendit Popullor të Shqipërisë. Siç e di turma, Rama ishte babai i kryeministrit 62-vjeçar, i cili e ka drejtuar vendin që nga viti 2013.

"Ndërsa trupi i tij lëkundej në litarin e trekëmbëshit," thotë gruaja e moshuar mes lotësh, "partia e drejtuar nga Edi Rama po vallëzonte."

Në vitin 1991, komunistët, të cilët quheshin Partia e Punës e Shqipërisë, ndryshuan emrin në Partia Socialiste e Shqipërisë. Rama nuk e ka dënuar kurrë në mënyrë të drejtpërdrejtë të atin, i cili vdiq në vitin 1998, megjithëse ka vënë në pikëpyetje nëse firma e tij është autentike. Ai e përshkroi ekzekutimin e Havzi Nelës si "një rast shumë të trishtueshëm", por nuk ka shkruar deri te kërkitimi i faljes për të, as si udhëheqës i vendit, as si bir i Kristaqit.

"Vetëm në Shqipëri ndodh që djali i një xhelati bëhet kryeministër," u thotë Lavdije Nela protestuesve.

Kur i përmend Ramës komentin e Nelës, ai vetëm thotë: "E kuptoj pse kjo histori mund t'u duket dramatike lexuesve tuaj, por ajo nuk ka vend në këtë diskutim, jo më pak sepse faktet nuk janë ashtu siç paraqiten zakonisht."

Ish-basketbollist profesionist dhe artist i trajnuar, Rama është një figurë me përmasa të mëdha që ka luajtur një rol kryesor në politikën shqiptare për pothuajse tre dekada. Fillimisht, si kryetar i Bashkisë së Tiranës nga viti 2000 deri në vitin 2011, dhe më pas si kryeministër, ai ishte vendimtar në transformimin e qendrës së kryeqytetit, ku një sërë kullash shumëngjyrëshe, të projektuara nga arkitektë të huaj të njohur, kanë riformësuar siluetën e qytetit dhe kanë marrë vlerësime pozitive nga kritikët për proiektimet e tyre.

Shumë shqiptarë nuk impresionohen. Flavia Osmani, një inxhinieri kompjuterike 26-vjeçare dhe protestuese e Flamingove, i sheh ndërtesat shumëkatëshe si simbole të egos së Ramës dhe të një ekonomie të narkotikëve. “Burimi kryesor i këtyre investimeve janë paratë e drogës,” pretendon ajo.

Ekziston një besim i përhapur se Shqipëria, e cila ende kryen një pjesë të madhe të aktiviteteve të saj tregtare me para në dorë, noton në paratë e pastruara të narkotikëve, që vijnë nga kriminelë të diasporës. E vërteta nuk është e lehtë të përcaktohet, por një raport i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike vlerëson se 50% e financimit të ndërtimit në vend vjen përmes “kanaleve informale”.

“Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë,” thotë Vladimir Karaj, një gazetar me Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Investigative në Shqipëri, “vetëm në Tiranë ka 40.000 apartamente bosh [një qytet me një popullsi prej rreth 600.000 banorësh]. Në të njëjtën kohë, çmimet e pronave janë rritur në mënyrë dramatike.”

Përveç ndërtesave të pabanuara në Tiranë, zona të mëdha të bregdetit kanë blloqe apartamentesh të pabanuara, ndërsa përgjatë autostradave kryesore ka një varg të pafund pikash karburanti, pothuajse një çdo 800 metra. Shumë shqiptarë besojnë se funksioni i tyre kryesor është pastrimi i parave. Rama është shpërfillës ndaj këtij lloji mendimi.

“Shumë besime të përhapura gjëresisht po shpëputen gjithnjë e më shumë nga e vërteta, faktet, shkenca dhe madje edhe nga aritmetika bazë,” thotë ai. “Ky është një prej tyre. Shifrat thjesht nuk e mbështesin këtë pretendim.”

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 12 Shtator12:59

[Berisha rikthehet sot nga SHBA/ Demokratët organizohen për ta pritur në Rinas](#)

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, rikthehet sot në Shqipëri pas vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara të Amerik...

POLITIKE 12 Shtator10:36

[Përvjetori i vrasjes së Azem Hajdarit/ Tritan Shehu: Simbol frymëzues, mesazhi i tij më aktual se kurrë](#)

Sot shënohet përvjetori i vrasjes së Azem Hajdarit, një prej figurave më të njohura të lëvizjes antikomuniste dhe t&eu...

POLITIKE 12 Shtator10:08

[KAYO dhe Korporata e Investimeve/ Tabaku: “Ishuj” të veçuar, por që formojnë një arkipelag të tërë paligjshmërie! Korrupsioni është taksë e fshehtë](#)

Deputetja e Partisë Demokratike Jorida Tabaku, ka ngritur akuza për mungesë transparence dhe kontrolli në disa prej strukturave shtetë...

POLITIKE 11 Shtator22:44

[43 ditë qëndresë ndaj ‘Territoriales’/ Divjaka në protestë kundër bashkimit me Lushnjën](#)

Kanë kaluar 43 ditë në protestë qytetarët e Divjakës dhe përsëri kërkojnë me ngulm mos miratimin e platform&eu...

POLITIKE 11 Shtator22:29

[“Na bllokuan në doganën malazeze!”, flet shqiptari: Jemi nisur nga Franca, na detyruan të hiqnim simbolet kombëtare](#)

Një protestues i cili vjen nga diaspora tregon për bllokimin dhe pengesat që hasën nga policia malazeze në pikën kufitare mes Bosn...

POLITIKE 11 Shtator21:58

[Pse e la qytetin për jetën si fermer? Gjergj Bojaxhi rrëfëhet si rrallëherë: Që kur kam qenë në Amerikë e bëj vetë bukën](#)

Gjergj Bojaxhi ka ndarë me publikun detaje nga jeta e tij. Ai tregoi arsyet pse vendosi që të largohej nga qyteti për në fshat dhe k&eu...

POLITIKE 11 Shtator21:43

[“Arrestoni Ramën, ju erdhi fundi”/ Protestuesit vijojnë marshimin në rrugët e Tiranës](#)

Protestuesit vazhdojnë marshimin nëpër rrugët e Tiranës. Pasi u ndalën për pak momente tek Rruga e Elbasanit, ata bën&e...

POLITIKE 11 Shtator21:24

[Rama për hetimet ndaj Belinda Ballukun: SPAK hyri në territorin tim si kryeministër](#)

Kreu i qeverisë, Edi Rama, u shpreh se zv.kryeministërja Belinda Balluku ka një çështje me drejtësinë, dhe se ai në lidhje m...

POLITIKE 11 Shtator21:09

[Me urdhër të Ramës, Mali i Zi bllokoi emigrantët shqiptarë në kufi, protestuesit marshojnë drejt ambasadës](#)

Protestuesit po nisin marshimin nëpër rrugët e kryeqytetit me thirrjet: Jep dorëheqjen! Rama në burg. Ata pritet të marshojnë...

POLITIKE 11 Shtator20:28

[Ahmetaj publikoi përgjimin, protestuesi: Rama dhe Yeffeti, skema për shitjen e Shqipërisë](#)

Ka hyrë në ditën e 104-t protesta qytetare kundër qeverisë së Edi Ramës, ku protestuesit vijojnë të kërkojnë&eu...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 11 Shtator

[EMRAT/ Vrasja e Ferdinand Hotit në Itali, kush ...](#)

Hetimet për vrasjen e Ferdinand Hotit, 35 vjeç, shqiptarit me banim në Mirano, po përqendrohen në botën e trafikut të drogës...

SHOWBIZ 11 Shtator

[VIDEO/ Dalin pamjet, ky është i dashuri i Franç...](#)

Gazetari Elton Tozaj ka rikthyer sërish në vëmendje jetën private të personazheve të showbiz-it. Këtë herë, në...

AKTUALITET 11 Shtator

[Plagoset me thikë 25-vjeçari në Shkzet, arrest...](#)


L Një plagosje me thikë ka ndodhur rreth mesditës në Durrës, në zonën e Shkzetit. Një i ri, rreth 25 vjeç, është...

INVESTIGIME 31 Maj 14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimeve...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.